

AKT      THEMELIMI

I SHOQERISE "DHEMBELI" sh.p.k.

I nenshkruari PAQESOR MALAJ, Ortak dhe Administrator i Vetem i Shoqerise "DHEMBELI" sh.p.k., me banim ne qytetin e Permetit,

V e n d o s a      :

- Krijimin e Shoqerise "DHEMBELI" sh.p.k.
- Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :  
Studiimi, projektimi dhe ndertimi i objekteve me punime idraulike (ujesjelles, kanalizime, impiante vadites, pune te mbrojtjes se sistemeve idraulike, kullimi, ujitje te tokave etj.)  
Ndertim te objekteve industriale, turistike, bujqesore, punime restaurimi, shembje etj.  
Konsultime e veprimtari preventivimi e situacionimi per objekte te ndryshme"
- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000 leke.
- Administrator i Vetem i Shoqerise eshte PAQESOR MALAJ.
- Jetegjatesia e shoqerise eshte 15 vjet.
- Qendra e Shoqerise eshte ne qytetin e Permetit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

/ Paqesor Malaj /



## S T A T U T

I SHOQERISE "DHEMBELI" sh.p.k.

K r e u 1.

### EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRINTARISE, QENDRA, JETEGJATËSIA.

Neni 1. Në bazë të Ligjes Nr. 7512 dt. 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private në përgjithësi, të nismës së lire, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" dhe Ligjes Nr. 7538 dt. 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" me vullnetin e tij të lire Ortaku i Vetëm PROFESOR MAMAJ krijon Shoqëri "DHEMBELI" shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar. Ajo është person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe normat e akteve të saj themeluese.

Neni 2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :  
STUDIMI, PROJEKTIMI DHE NDERTIMI I OBJEKTEVE NË FUSHEN IDRAULIKE (UJESJELLES, KANALIZIME, IMPIANTE VADITES, PUNIME TË MBROJTJES SË SISTEMEVE IDRAULIKE, KULLIMI E UCITJE TË TOKAVE ETJ.) SI DHE NË NDERTIME CIVILE E KOMPLETIM ME INSTALIME TË NEVOJSHME.

NDERTIMIN E OBJEKTEVE INDUSTRIALE, TUBTSTIKE, BUJQESORE, PUNIME RESTAURIMI, SHEMBJESH ETJ.

KONSULTIME E VEPRIMTARI PREVENTIVIMI E SITUACIONIMI PER OBJEKTE TE NDRYSHME.

Neni 3. Shoqeria ka qender ne qytetin e Permetit.

Me vendim te saj shoqeria mund te krijoje qendra dytesore si filiale, agjensi apo perfaqesi.

Neni 4. Jetegjatesia e shoqerise eshte 15 vjet.

Shoqeria mund te shperndalet perpara ketij afati me vendim te Ortakut te Vetem, ose kur verifikohen rrethana te tilla kur shperndarhja e urdheron ne menyre te shprehur ligj.

K r e u II.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE.

Neni 5. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000 leke.

Ai i perket teresisht Ortakut te Vetem, eshte nenshkruar e shlyer teresisht prej tij ne para.

Me vendim te Ortakut te Vetem, i cili regjistrohet ne Librin e Shoqerise, kapitali themeltar i shoqerise mund te ndryshohet.

Eshte e ndaluar qe kapitali themeltar i shoqerise te perfaqesohet nga letra me vlere te trehgetueshme apo sherbime

Neni 6. Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne kuota nga 1.000 leke secila, apo shumefishe te saj

Per transferime te kuota me cdo titull eshte kompetent vetem Ortaku i Vetem.

Neni 7. Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitjeje te detyrueshme te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i riblejeto keto pjese e te deklaroje zvogelimin e kapitalit te saj themeltar.

K r e u III.

#### ORGANET E SHOQERISE. ADMINISTRIMI.

Neni 8. Ortaku i Vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Atij i takojne te gjitha kompetencat qe ne Ligjen "Per Shoqerite Tregetare" i jane dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e Ortakut te Vetem regjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Neni 9. Cdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykatën e Rrethit Tirane anulimin e vendimeve te Ortakut te Vetem te marra ne kundërshtim me ligjen dhe normat e ketij statuti.

Neni 10. Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Neni 11. Mandati i Administratorit eshte i pakufizuar ne kohe. Ai mund te revokohet vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 12. Administratori ka te drejte te kryeje çdo veprim administrimi ne interes te shoqerise, brenda objektit te veprimtarise se saj. ~~At~~

Neni 13. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur ato nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te rasteve kur ajo provonse te tretet e dinin qe akti i administratorit tejkalonte objektin e veprimtarise se shoqerise, ose nuk mund ta injoronin kete fakt ne rrethana te caktuara.

Neni 14. Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfqesimi i saj ndaj te treteve.

#### K r e u IV.

#### BILANCI DHE FITIMET.

Neni 15. Viti financiar i shoqerise mbyllet me 31.12 te çdo viti. Me kete rast administratori ben inventarin dhe llogarite vjetore, sipas dispozitave per kontabilitetin dhe harton nje raport me shkrimë per administrimin.

Bilancit i bashkohen :

- Nje sitaacion per garancite e dhena nga shoqeria.

- Nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria.

Neni 16. Perderisa "rezerva e domosdoshme" te arrije 1/10 e kapitalit themeltar shoqeria eshte e detyruar te depozitoje ne fund te çdo viti financiar 2/20 e fitimit te realizuar.

Neni 17. Fitimet, pasi te jene depozituar shumat e urdheruara per rezerven etj. i takojne teresisht Ortakut te Vetem.

Neni 18. Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda dates 31.3. te vitit pasardhes.

Neni 19. Ne rast te caktimit te likudatorit, ne nje likuidim te mundeshem te shoqerise, likuidatori merr te gjitha atributet e Administratorit te Shoqerise.

Tirane, me 24.5.1994.